

# **JAVA E INOVACIONIT**

**UDHËZUES PËR ORGANIZIM**

## IDEJA

**Java e Inovacionit** është aktiviteti kryesor i vitit i organizuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për të promovuar Inovacionin në të gjithë sektorin TIK, por jo vetëm. Një event në mbarë vendin që ka për qëllim të krijojë përkohshmërinë vjetore duke sjellë risinë në fushën e Inovacionit dhe Teknologjisë në Shqipëri.

Dke sjellë së bashku aktorët e inovacionit, Java e Inovacionit zhvillon iniciativa të reja në vend.

Çdo vit iniciativat dhe tematikat janë të ndryshme. Qëllimi është të synohet bashkëpunim, përfshirje sa më e gjerë e bizneseve për t'u njohur dhe përfituar nga shërbimet publike si dhe për tu ndërgjegjësuar me arritjet në këtë sektor.

*Objektivi* është promovimi i inovacionit në të gjithë sektorët e shoqërisë.



**TAKIM**

## **Organizohet në të gjithë vendin, rreth inovacionit dixhital**

Objektivi i Javës së Inovacionit është të bashkojë aktorët e inovacionit, start-up-et, inkubatorët, akseleratorët, shkollat, qendrat e teknologjisë dhe konkurrencës, sipërmarrjet e mesme të mëdha e të vogla, për të mbledhur ekosistemin e tyre dhe publikun në tërësi, përmes sponsorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me qëllimin e përbashkët: atë të revolucionit dixhital.



## LIDHJE

Aktorët e inovacionit dixhital!

Inovacioni fillon me dëshirën për të vlerësuar iniciativat e reja në territorin ndërkombëtar, për të krijuar një fushatë mediatike rreth inovacionit, për aktorët ekonomikë shqiptarë dhe ti lejojë çdonjërit prej tyre të shkëmbejë dhe të ndajë ide rreth inovacionit.



## SHPIK

Risia në zemër të rritjes!


Rregjistrohu në një rrjet dinamik i krijuar nga iniciativa private dhe nga ato të mbështetura nga institucionet publike. Merrni pjesë në promovimin e kulturës së sipërmarrjes si një vektor i inovacionit dhe i rritjes në Shqipëri. Përfitoni nga shikueshmëria te [inovacioni.gov.al](http://inovacioni.gov.al) si dhe në mediat lokale.

# JAVA E INOVACIONIT

Follow **Innovation week** on:

<http://inovacioni.gov.al/>



Për të patur Javë Inovacioni të suksesshme është e rëndësishme që aktivitetet të përmbushin disa kritere. Këto kanë si qëllim të sigurojnë suksesin e kësaj jave duke përcaktuar një kuadër të përbashkët për ngjarjet e ndryshme të cilat do ti ofrohen publikut.

## **ENERGJIA E NGJARJEVE TË JAVËS SË INOVACIONIT**

Një ngjarje ka si objektiv të lejojë shkëmbimin dhe të ndajë eksperiencat. Edhe pse e vendosur në një kornizë profesionale, atmosfera e saj është miqësore dhe e qetë.

## **PROFILI I ORGANIZATORËVE**

Të gjitha llojet e strukturave mund të kërkojnë të marrin pjesë në ngjarjet e Javës së Inovacionit, me kusht që të angazhohen në përputhje me këto rekomandime.

Nëse ju jeni një start-up, një agjensi, një biznes i vogël apo i madh, një shoqatë, një shkollë ose diçka tjetër, ju mund të bëheni pjesë e ngjarjes. Në mënyrë që të përmirësoni anën mediatike dhe efektin viral të aktivitetit tuaj, në kuadër të Javës së Inovacionit, ne ju këshillojmë të ndiqni formatet e mëposhtme:

## **MËNGJESI**

Është një takim në mëngjes, në të cilin ju prezantoni risinë tuaj si dhe produktet apo shërbimet që ajo ofron.

Kohëzgjatja e rekomanduar: 2 orë

Ne ju rekomandojmë të përfundoni aktivitetin tuaj jo më vonë se ora 10 në mënyrë që pjesëmarrësit e ardhur të mund të shkojnë në punë.

## **Workshop**

Është një takim në të cilin ju i prezantoni audiencës raste praktike në lidhje me inovacionin. Mos hezitoni të jeni krijues dhe të propozoni tema origjinale dhe të kohës. Si përshembull “transporti në 2020”

Kohëzgjatja e rekomanduar: 1 orë

## **Sesione networking**

Për të kombinuar dobishmërinë dhe kënaqësinë, ky format ju lejon të ftoni bashkëpunëtorët tuaj, kontaktet tuaja si dhe klientët që ju keni, në mënyrë që ata të prezantojnë produktet apo shërbimet si dhe të shkëmbejnë tematikat në lidhje me inovacionin.

Do të ishte e këshillueshme që ky sesion të organizohej pas orarit të punës.

Kohëzgjatja e rekomanduar: 1 orë



## **MADHËSIA E AKTIVITETIT**

Qëllimi juaj është që të tërhiqni një numër të lartë shikueshmërie. Gjithashtu për të qenë Java e Inovacionit, duhet që të keni një minimum prej 30 pjesëmarrësish.

## **TARIFAT E AKTIVITETIT**

Aktiviteti duhet të ketë hyrjen falas. Detyrimet financiare për organizmin e tij duhen mbuluar falë partneriteteve vendore apo sponsorave.

## **VENDI I AKTIVITETIT**

Ju jeni të lirë të zgjidhni vendin që ju duket se përmbush të gjitha kushtet e formatit tuaj. Vende të këshillueshme mund të jenë ambjentet e një shkolle, e një hoteli, bari apo restoranti. Duhet të merrni në konsideratë qeranë e vendit që po e organizoni si dhe lehtësinë për pjesëmarrjen e publikut.

## KOMUNIKIMI PARAPRAK I ÇELJES SË JAVËS SË INOVACIONIT

### NË RRJETET SOCIALE

Ju inkurajojmë të komunikoni sa më shumë të jetë e mundur në rrjetet sociale, për të publikuar iniciativën tuaj si dhe për të maksimizuar shikueshmërinë dhe efektin viral të ngjarjes tuaj.

Për të rritur shikueshmërinë e përmbajtjes, ju lutem përdorni hashtagun #javaeinovacionit. Një hashtag specifik gjithashtu mund të ngrihet për çdo ngjarje dhe përdorimi i dy hashtageve duhet të bëhet së bashku.

Në facebook ju mund të përdorini një faqe për të komunikuar eventin tuaj, por rregjistrimi për pjesëmarrje duhet të bëhet ekskluzivisht në platformën e faqes së internetit të Javës së Inovacionit.

## **FAQJA E INTERNETIT**

Përshkrimet për aktivitetin tuaj duhet të paraqiten në platformën e posaçme Java e Inovacionit. Kjo faqe ju lejon të përfitoni nga një website i dedikuar aktivitetit tuaj, i cili është një mjet ideal shikueshmërie.

Ekskluzivitetin e regjistrimi të pjesëmarrësve duhet ta ketë vetëm ky website.

## **KOMUNIKIMI gjatë javës së INOVACIONIT**

Ne do të krijojmë hashtag #JavaeInovacionit, i cili na siguron promovimin e aktiviteteve si dhe afërsinë me komunitetin. Gjithashtu mund të krijohet dhe hashtagu plotësues i cili do të na mbështesë akoma dhe më shumë për të patur një audiencë maksimale.

Gjatë ngjarjeve kemi krijuar një histori e cila është transmetuar në rrjetet sociale për ti mundësuar të gjithë publikut informacionet me pikat e forta dhe mundësitë e teknologjisë dhe inovacionit.

## **MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN, LAJMET, MEDIA**

Duke ofruar një aktivitet të organizuar në kuadër të Javës së Inovacionit, ju jeni përgjegjës për promovimin e tyre në nivel kombëtar e më tej.

## **BRANDIMI**

Ju do të përfitoni nga marrëdhëniet e krijuara me partnerë të rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmëri e kësaj jave e dedikuar risisë. Prandaj sponsorët kombëtarë kontribuojnë në shikueshmërinë e këtij eventit.

## **LOGO**

Logot që do të shoqërojnë javën e inovacionit duhet të jenë në dispozicion në cdo material provues për të siguruar suksesin e eventit.

# HAPAT PËR MBULIMIN MEDIATIK

## 1. Qartësimi i qëllimit dhe mesazhit

- Cili është qëllimi i ngjarjes? Si do e titulloni?
- Kush është audiencia e synuar? Çfarë mjetesh do përdoren për të arritur këtë audiencë? Çfarë mesazhesh do të përcillen me atë audiencë?
- Pse është kjo javë e vlefshme? Çfarë është unike, e kohës, krijuese, e mrekullueshëm në lidhje me aktivitetin tuaj?
- Cilat janë 2-3 mesazhet kryesore, të cilat doni tua jepni njerëzve?

## 2. Planifikoni eventin tuaj duke patur MEDIAN në mendje

- Zgjidh një vend që është lehtësisht i arritshëm për mediat, për shembull. në qendër të qytetit, stacionet pranë TV, etj
- Zhvillimi i ngjarjeve të përkojë me ciklin e lajmeve. Për shtypin ngjarjet nga e hëna deri të premten në mëngjes (11 am) janë më të mira. Për televizionin, ora 18:00 mund të jetë e mirë për një transmetim të drejtpërdrejtë në lajmet e mbrëmjes.

- Krijoni shenja, efekte, imazhe etj të cilat pasqyrojnë mesazhet tuaja kryesore, dhe mbahen mend nga audienca juaj, e cila është duke ju parë ju nëpërmjet medias. Pra, ju doni imazhe që kanë kuptim kur shfaqen në një foto apo për vetëm disa sekonda.

### **3. Përgatitni materialet**

- Hulumtoni dhe përgatitni një listë me mediat kryesore të zonës tuaj, ata që ndjekin hapat tuaj, TV lokale, stacionet e radios, lajmet e komunitetit, lajme opinionistësh, radio shows etc
- Përgatitni një listë të mediave të gazetarëve kyçe
- Bëni një listë me email, numrat e telefonit si kontakte të rrjeteve sociale.
- Dërgoni një lajmërim për zhvillimin e ngjarjes një ditë para
- Përgatitni një njoftim për shtyp pas ngjarjes.

### **4. Përgatitni një strategji për median sociale**

- Zgjidhni një hashtag dhe promovojeni atë
- Krijoni imazhe që shpërndahen lehtësisht

- Krijoni një linjë më titullin “pyesni” si një peticion online për tu plotësuar nga njerëzit
- Njoftoni rrjetin tuaj kombëtar për të bërë retweet eventin në kohë reale

## **5. Shpërndarja Mediatike**

- Dërgo një këshillues të medias 2-3 ditë në avancë, dërgoni email personale gazetarëve, që njihni. Pas emailit bëni një telefon në formë kujtese.

## **6. Identifikoni rolet dhe përgatisni njerëzit për detyrat e tyre**

- Vendosni një pikë kontakti për median. Ky person është në kontakt të drejpërdrejtë me mediat dhe materialet e shtypit, puna e tij është që të drejtojë të gjithë zëdhënësit drejt informacionit të duhur, të marrë dhe japë kontakte, të japë materialet mediatike, të përshëndesë shtypin.
- Zëdhënësit: nevoja për tu përgatitur për të folur duke caktuar pikat, të cilat duhen praktikuar më parë.
- Fotografët, përgatitini me llojin e fotove që ju dëshironi të paraqiten.

- Videografi, përgatitini me llojin e materialit që duhet të shfaqin.
- Gjithmonë live në tweeter.

## **7. Bisedoni me Shtypin**

- Tani ju jeni gati për të dhënë intervista, vishuni në formë të përshtatshme, flisni me fjalë kyçe dhe me pika të menduara më parë
- Vendos njoftimin për shtyp online, tweet atë në gazetarët kyc, dorëzoni versionin letër te gazetarët që do të shfaqen në ngjarje.

## **8. Ndiqe**

- Përditësoni median me ngjarjet në event, duke bashkëngjitur foto ose video, gjithashtu dërgoni me email listës së krijuar të gazetarëve.
- Vendosni fotot tuaja online së bashku me videot dhe shpërndajeni gjerësisht.
- Postoni lidhje për mbulimin e lajmeve në facebook dhe twitter.



- Personalisht falënderoni gazetarët të cilët treguan dhe mbuluan ngjarjen. Shkruani një editorial se pse kjo ngjarje ishte e rëndësishme dhe pse ishte e rëndësishme përfshirja.

## **GJETJA E SPONSORAVE**

Si ti propozojmë idenë një sponsori?

Për të mbuluar shpenzimet financiare në organizmin e aktivitetit tuaj do të lindi nevoja e kërkimit për donator. Një format aplikimi si më poshtë është vënë në dispozicion për tu plotësuar përpara çdo aktiviteti. Gjithsesi duhet patur parasysh se çdo donator ka një format të tijin, po pikat e mëposhtme janë kryesore në çdo aplikim.

Buxheti i vendosur për ju nga një sponsor duhet të jetë i dedikuar tërësisht për të mbuluar shpenzimet që lidhen me eventin. Gjithashtu sponsorët nuk duhet të ndikojnë në përmbajtjen dhe formatin editorial të aktiviteteve.

## Format Aplikimi për Sponsor

Emri i aktivitetit:

Vendodhja:

Datat e eventit:

Adresa elektronike

e Javës së

Inovacionit:

Sponsori i Propozuar:

Arsyet e financimit:

Qëllimi:

Objektivat:

Rezultatet:

Përfituesit:

## FORMAT FTESE

MINISTRI I SHTETIT PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE ZNJ. MILENA HARITO, ka kënaqësinë t'Ju ftojë në edicionin e \_\_\_\_ të JAVËS SË INOVACIONIT

### *Tema*

Ky do të jetë aktiviteti i \_\_\_\_ në kuadër të nismës java e inovacionit dhe do të shërbejë jo vetëm për të \_\_\_\_\_ por gjithashtu do të jetë një rast i përshtatshëm për të shkëmbyer duke përmirësuar dhe pasuruar këtë nisëm në të ardhmen.

Të bindur, se pjesëmarrja juaj do t'i jepte kësaj dite më shumë vlerë!

Ju mirëpresim ditën e \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 201\_, ora \_\_\_\_\_ pranë  
\_\_\_\_\_

JU LUTEM PARAQITNI FTESËN NË HYRJE

**JAVE INOVACIONI TE MBARE TE GJITHEVE!  
NE JEMI KETU PER T'JU NDIHMUAR PER CDO PYETJE QE TE  
KENI, MOS HEZITONI TE NA KONTAKTONI:**

[info@asdo.al](mailto:info@asdo.al)